



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 1377 Prot.

Lezhë, më 28 . 01 . 2021

VENDIM

Nr 05 , Datë 27 / 01 / 2021

**“PËR MIRATIMIN E LISTËS SË TË PASTREHËVE QË PËRFITOJNË
SUBVENCIONIM TË QIRASË PËR VITIN 2021”**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, ligjit nr 22/2018 “Për Strehimin Social”, VKM nr.362 datë 29.05.2019 “Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit, dhe mënyrën e llogaritjes së tij”, VKM nr. 384 datë 12.06.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimit dhe Kujdesit Social, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë:

VENDOSI:

1. Të miratojë listën e të pastrehëve që përfitojnë subvencionim të qirasë për vitin 2021, sipas shtojcës A me numër rendor 55 që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Në zbatim të këtij Vendimi, Bashkia Lezhë t'i paraqesë kërkesën Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për financimin e subvencionimit të qirasë nga buxheti i shtetit, me afat kohor 1 vjeçar.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI

FLORIDA ÇUNAJ

KRYETARI

ERNEST RAKAJ

